



FORMULARI MBI TË DREJTËN E AUTORIT NGA KN CIGRE Kosovë

Titulli i Punimit: _____

Komiteti Studiues: _____

Autor(ët)i: _____

PËLQIMI PËR PUBLIKIMIN E PUNIMIT DHE TRANSFERIMIN E TË DREJTËS SË AUTORIT

Unë/Ne si pronar(ë) i të drejtës së autorit të punimit të mësipërm, me anë të këtij pëlqimi dorëzoj (dorëzojmë) punimin te Sekretariati i KN CIGRE Kosovë për publikimin e tij.

Me qëllim të përfshirjes së punimit të lartcekur në përmbledhjen e punimeve të Konferencës së KN CIGRE Kosovë, unë/ne (individualisht dhe së bashku) nënshkruaj(më) si pronar(ë) i të drejtës së autorit në këtë punim. Pas pranimit të punimit tim(tonë) për publikim nga KN CIGRE Kosovë, unë/ne si pronar(ë) dhe i/të autorizuar transferoj(më) të drejtën e autorit të punimit të lartpërmendur tek KN CIGRE Kosovë sipas kushteve të përcaktuara në dispozitat e dhëna në këtë formular.

A. Për autorin kryesor:

Nënshkrimi: _____ Datë: _____

Emri, mbiemri dhe adresa e autorit përgjegjës për komunikim me KN CIGRE Kosovë

Tel.: _____ E-mail: _____

B. Për një përfaqësues të autorizuar të një organizate që mban të drejtën e autorit:

Nënshkrimi i përfaqësues të autorizuar: _____

Në emër të organizatës: _____

Datë _____

(Organizata)

Emri dhe adresa e organizatës:

Tel.: _____ E-mail: _____

Ju lutemi, plotësoni të gjitha informacionet e kërkuara dhe bashkëngjitni këtë formular nëpërmjet platformës www.cigre-ks.com

DISPOZITAT E TË DREJTAVE TË AUTORIT NGA KN CIGRE Kosovë

Këto dispozita rregullojnë procedurën dhe kërkesat për publikimin e punimeve ose abstrakteve që duhet të dorëzohen në KN CIGRE Kosovë për publikim. Formulari në anën e pasme të listës që rregullon miratimin për publikimin e punimeve dhe transferimin e të drejtës së autorit duhet të kompletohet dhe të kthehet në KN CIGRE Kosovë.

1. Politika e KN CIGRE Kosovë është që të ketë të drejtën e autorit për një kontribut teknik që publikohet në interes të KN CIGRE Kosovë, autorëve të tij dhe punëdhënësve të tyre dhe për të lehtësuar përdorimin e duhur të këtyre materialeve nga të tjerët.
2. KN CIGRE Kosovë publikon dhe shpërndan punime brenda vendit. Kur një punim dorëzohet për publikim në KN CIGRE Kosovë, atëherë pranimit i saj nënkupton automatikisht që KN CIGRE Kosovë ka të gjitha të drejtat që lidhen me to, në përputhje me ligjin dhe këto Dispozita.
3. Lidhur me punimet e dorëzuara, KN CIGRE Kosovë zbaton politikat e mëposhtme: KN CIGRE Kosovë ofron prezantimin dhe paraqitjen e materialeve të punimeve në kuadër të Konferencës, publikimin e tyre, si dhe qasjen e përdoruesve në këto punime si aktivitet që shërbehet nga KN CIGRE Kosovë. Nëse publikimi i punimeve të paraqitura kërkon pëlqimin e palëve të tjera, atëherë kjo është përgjegjësi e autorit për t'ia dhënë atë e jo e KN CIGRE Kosovë.
4. Nëse e drejta e autorit për të paraqitur punimin i takon autorit (autorëve), atëherë pëlqimi për publikim duhet të nënshkruhet nga autor(ët)ji në formën nën A, duke vënë njëkohësisht edhe datën.
5. Nëse autori i takon një organizate që e punëson autorin ose është një punë që lidhet me veprimtarinë e asaj organizate, atëherë pëlqimi për publikim duhet të nënshkruhet nga një përfaqësues i organizatës, në formën nën B, duke vënë njëkohësisht edhe datën.
6. Autor(ët)ji dhe/ose organizata që kanë dhënë pëlqimin për transferimin e të drejtës së autorit kanë këto kompetenca:
 - të mbajë të gjitha të drejtat e pronësisë përveç të drejtës së autorit, sikurse që janë të drejtat e patentës;
 - për të riprodhuar imazhet dhe performancat nga punimi me njoftimin paraprak dhe në kohë të Sekretariatit të KN CIGRE Kosovë.
 - që të ripërdorë në tërësi ose pjesërisht punimin me qëllim të kryerjes së punimeve të tjera;
 - pa pagesë mund të kopjojnë punimet e botuara/publikuara për nevojat e tyre, por jo për shitje, me kusht që ata të mos thirren në emër të KN CIGRE Kosovë që mund të sugjerojnë promovimin e disa produkteve, shërbimeve apo prodhuesve të caktuar nën simbolin e KN CIGRE Kosovë.
7. Nëse punimi nuk pranohet, atëherë e drejta e autorit të punimit i mbetet autor(ëve)it origjinal. Nëse punimi pranohet mirëpo nuk publikohet brenda një periudhe të arsyeshme pas pranimit, atëherë autor(ët)ji ka (kanë) të drejtën të kërkojë (kërkojnë) që KN CIGRE Kosovë të rikthen të drejtën e autorit tek autor(ët) origjinal.